



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Komuna Hani i Elezit
Municipality of Hani i Elezit

02/ 2631 /2026
18.03.2026

Në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publik nr.08/L-197 neni 80, neni 81 dhe 82, Ligjit të Punës nr.03/L-212 neni 8, Rregullores (QRK) nr.30/2024 për Procedurën e Pranimi të Nëpunësve të Shërbimit Publik në Sektorin e Shëndetësisë neni 5, 6, 7, dhe 8, Komuna Hani Elezit shpall:

KONKURS PËR PRANIM

(Aplikimi është i hapur për gjithë kandidatët e interesuar)

Institucioni/ Drejtoria: Komuna Hani i Elezit/Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Titulli i pozitës së punës: Mjek/e i/e Përgjithshëm

Numri i kërkuar: (3) tre

Vendi i punës: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “ Dr.Menduh Kaloshi”

Lloji i pozitës: Nëpunës i Shërbimit Publik

Koeficienti/paga: H 10/8.40

Kohëzgjatja e Kontratës: Periudhë e pacaktuar (Periudha provuese 6 muaj)

Orët e punës: 40

Përshkrimi i detyrave të punës:

1. Ofron shërbime me standard të lartë mbështetur në mjekësinë e bazuar në dëshmi si dhe ofron shërbime gjithëpërfshirëse për individin/pacientin dhe familjen në të gjitha fazat.
2. Harton dhe zhvillon planin e trajtimit të sëmundjes dhe trajton pacientin dhe përcakton diagnozën diferenciale dhe diagnozën e punës në përputhje me simpatologjinë.
3. Përcjellja sistematike e rritjes së zhvillimit të fëmijëve dhe adoleshentëve, kujdesi për personat e moshuar në nevojë dhe ofron kujdes për rastet urgjente dhe i referon rastet me kohë dhe në mënyrë adekuate.
4. Interpreton rezultatet e testeve të shpejta laboratorike, komunikon ose konsultohet me specialistë të mjekësisë familjare sipas nevojës si dhe referon pacientin te specialisti i mjekësisë familjare dhe për kujdes spitalor.
5. Kujdesi i vazhdueshëm për pacientët me sëmundje kronike jo ngjitëse, kontrolli i sëmundjeve ngjitëse (hulumtimet epidemiologjike) si dhe promovimi shëndetësor dhe parandalimi i sëmundjeve si dhe shërbimet në komunitete (grupet vulnerable, vendet rurale, shkolla, komunitete).
6. Zbatimi i programit të vaksinimit, edukimi shëndetësor etj. inkurajohet nga puna ekipore (specialistit i mjekësisë familjare, infermierët, etj.) si dhe vlerëson efektivitetin e kujdesit të ofruar nga ekipi i mjekësisë familjare, identifikon problemet dhe kërkon nga anëtarët e ekipit zgjidhjen e tyre.
7. Përcaktohet nga specialisti i mjekësisë familjare si pjesë e ekipit të mjekësisë familjare në përputhje me nevojat e pacientit, aftësitë dhe kualifikimet për të përmbushur nevojat e institucionit, merr pjesë në trajnime, vlerësim të kompetencave, orientim dhe edukim.

8.Kryen edhe punë administrative, vepron në mënyrë profesionale, duke rrespektuar rregulloret për KPSH dhe vepron në përputhje me të gjitha rregulloret, procedurat dhe politikat e MSH në fuqi, përcakton diagnozën përfundimtare dhe përshkruan terapinë, i nënshtrohet programit nacional të zhvillimit të vazhdueshëm profesional si dhe përkujdeset për konfidencialitetin e individit,

9. Identifikimi i grupeve të veçanta të rrezikut, merr pjesë në grupet e rishqyrtimit kolegjal dhe sjell vendime të përbashkëta për menaxhimin e sëmundjeve si dhe ndihmon specialistin e mjekësisë familjare në zhvillimin mjekësor në institucionin përkatës.

10. Merr pjesë në takime, konferenca dhe tregojnë interesim në zhvillimin e strategjive për përmirësim të intervenimeve klinike dhe nivelit të lartë të kujdesit ndaj pacientit dhe tregojnë aftësi për zbatim të vazhdueshëm të detyrave të punës,

11. Kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

Kriteret e përgjithshme për pranim:

-Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës, të ketë zotësi të plotë për të vepruar, të zotëroj njëren nga gjuhët zyrtare në pajtim me Ligjin për Gjuhët, të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse, të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprë penale me dashje, të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik, të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe /apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës, të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.

Kërkesat e përgjithshme formale dhe të nevojshme:

Arsimimi i kërkuar: **Fakulteti i Mjekësisë së Përgjithshme.**

Të jetë i regjistruar dhe licencuar

Shkathtësi në komunikim, planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit.

Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave.

Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (word, excel etj.)

Dokumentet që duhet paraqitur për aplikim:

1. Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës.

2. Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të kontratës.

3. Kopjet e dëshmisë së punësimit (vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë. Dëshmisë e punësimit jashtë institucioneve publike duhet të mbështet së paku njëra nga dëshmitë si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personal. Përvoja e punës, e cila deklarohet sipas kushteve të konkursit , e fituar në një shtet tjetër, dëshmohet përmes dëshmisë së përkthyer mbi përvojën e punës së lëshuar nga organi kompetent i atij shteti, apo përmes dëshmisë së përkthyer dhe noterizuar të përvojës të lëshuar nga punëshënësi përkatës.

4. Kopjen e licencës së punës të lëshuar nga organi kompetent (me afat).

5. Dëshmitë e trajnimeve profesionale të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi i ka realizuar në cilësinë e trajnuesit.

6. Dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (kandidatët që janë të punësuar apo kanë qenë të punësuar në institucione publike).

7. Kopjet e dokumenteve tjera që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.

Dokumentet që dorëzohen në fazën e verifikimit para emërimit:

1. Dëshmi përkatëse se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar.
2. Certifikatën mbi denimet penale origjinale e lëshuar nga gjykata përmes së cilës dëshmohet se nuk është i/e dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje, jo më të vjetër se 6 muaj nga data e lëshimit.
3. Diploma e kualifikimit arsimor e noterizuar.
4. Dëshmi se kandidati është i aftë në pikëpamje shëndetësore.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve:

Sipas Rregullores (QRK) nr.30/2024 për Procedurën e Pranimit të Nëpunësve të Shërbimit Publik në Sektorin e Shëndetësisë.

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda (30) ditëve nga data 19.03.2026 deri më 17.04.2026 nga ora 08:00-16:00.

Të gjithë kandidatët e interesuar aplikacionin e punësimit mund t'i marrin në formë fizike pranë Qendrës për Shërbim me Qytetarë në Komunë në Han të Elezit dhe të plotësuar e dorëzojnë në të njëjtin vend, apo ti shkarkojnë në portalin shtetëror <https://konkursi.rks-gov.net>

Dokumentacioni i kandidatëve të cilët nuk i plotësojnë kriteret e konkursit nuk do të shqyrtohen ndërsa në faza tjera do të ftohen vetëm kandidatët që i plotësojnë kriteret e që futen në listë të ngushtë.

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre inkurajohen të aplikojnë në këtë pozitë.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Kandidati përmes aplikacionit deklaron dhe mban përgjegjësi për vërtetësinë e të gjitha dokumenteve të dorëzuara siç kërkohen nga shpallja e procedurës së rekrutimit. Deklarimi i rrejshëm paraqet shkas për përjashtim nga procedura e rekrutimit.

Konkursi dhe rezultatet shpallen në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/>, web faqen e komunës <https://hannielezit.rks-gov.net> dhe në tabelën e shpalljes.

Kryetari i Komunës

Mehmet Ballazhi

M. Ballazhi

